



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1561/Prot.

Tiranë, më 13/12/2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 54 datë 13/12/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) Tiranë.

KONSTATOVA

Në datë 14/11/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave “klient”, “punonjës”, sipas ligjit 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, udhëzimit nr. 21 datë 24/09/2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrollues të mëdhenj”
- Procesi i njoftim regjistrimit
- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

Kontrolluesi ushtron veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në këndvështrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) Tiranë merr cilësinë e kontrolluesit, pasi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, sheërbimeve dhe produkteve që ofron, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “klientë” dhe “punonjës”.

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në nenin 3 përkufizon; “Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Nisur nga relacioni i grupit të kontrollit administrativ dhe procesverbali i kontrollit të mbajtur nga grupi i kontrollit rezulton se; kontrolluesi Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB) Tiranë, mbledh dhe përpunon të dhëna personale në rrugë manuale dhe në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik.

Përpunimi i të dhënave në rrugë manuale për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale "klient dhe "punonjës" bëhet nëpërmjet mbledhjes dhe ruajtjes së dokumentacionit me të dhëna personale të paraqitur, për marrjen e shërbimeve dhe produkteve si dhe për dosjet e krijuar nga departamenti i burimeve njerëzore.

Përpunimi i të dhënave personale më i përhapur për kontrolluesin ICB-bankë është përpunimi në rrugë elektronike që realizohet nëpërmjet sistemit elektronik që kontrolluesi ka të instaluar në qendër dhe në çdo degë të tij për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të tij.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezulton se kontrolluesi ICB- Bank, garanton mbrojtje të të dhënave personale, nëpërmjet përpunimit të drejtë, të ligjshëm dhe të sigurt të tyre, në sajë të masave që kontrolluesi ka marrë sa i përket sigurisë së informacionit dhe sekretit bankar, zbatimit të legjislacionit në fushën bankare, monitorimit të vazhdueshëm të autoritetit mbikëqyrës Bankës së Shqipërisë, zbatimit të akteve dhe udhëzimeve të nxjerra prej tij.

Kontrolluesi zbaton politika për sigurinë e informacionit të përmbledhura në dokumentin " Guida e procedurave për sistemet e teknologjisë së informacionit".

Pavarësisht sa më sipër , grupi i kontrollit administrativ në procesverbalin e mbajtur në datën 09/12/2013 ka konstatuar se;

- 1) Kontrolluesi Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB) Tiranë, nuk ka hartuar rregullore të veçantë ku të përcaktohen qartë rregulla për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, kohën e ruajtjes, procedurat e asgjësimit të të dhënave personale, në rrugë manuale dhe elektronike, për subjektet e të dhënave personale, në respekt të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neni 27 "*Masat për sigurinë e të dhënave personale*".
- 2) Kontrolluesi Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB) Tiranë, mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet video-survejjimit (regjistrim me kamera), duke mos përcaktuar rregulla të shkruara, për përdorimin e këtij sistemi, si kundër parashikohet në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 6, 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "*Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*".
- 3) Kontrolluesi Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB) Tiranë, në faqen e saj të internetit nuk ka vendosur rubrikën "politikat e privatësisë", ku të përfshihen kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Duke vlerësuar konstatimet e grupit të kontrollit administrativ në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) ,të hartojë rregullore të veçantë ku të përcaktohen qartë rregulla për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, koha e ruajtjes, procedurat e asgjësimit të të dhënave personale, në rrugë manuale dhe elektronike, për subjektet e të dhënave personale. (*Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë*).
2. Në zbatim të neneve 6, 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "*Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", kontrolluesi Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) të hartojë rregulla të shkruara, për përdorimin e sistemit CCTV dhe të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale nëpërmjet tabelave informuese.
3. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Banka Ndërkombëtarë Tregtare (ICB) në faqen e internetit, të vendosë rubrikën "politikat e privatësisë", ku të përfshihen kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.
4. Kryerja e detyrave të lëna në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej 1 (një) muaj, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave"*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

